# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-433121**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ia lidhën duart dhe e qëlluan nga afër, detaje tronditëse nga vrasja e shqiptarit në Itali, identifikohet 35-vjeçari (EMRI) – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/ia-lidhen-duart-dhe-e-qelluan-nga-afer-detaje-tronditese-nga-vrasja-e-shqiptarit-ne-itali-identifikohet-35-vjecari-emri/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 12:20:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 12:18:17 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `62211be50fa063f5810e1eeee3a7093462e59e860aad68bcb8b7d24f6b7d2c3b` |
| TEKSTI | `8a397312ad7ba205c932c5d76e6b9c5960ae2ec2820f3ec7db68b86bdf0dba21` |
| PAMJA | `6068af9b820f64252e836712b63d836b94cd560182165bc200ccef22891f1379` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `292a7c82beeef71102411cb0782c25ef60a20396b131cc375d4f7c1a8d090546` |
| E MËPARSHMJA | `c49fbe9ef6e3614256246d3759c8f03587fc76bc1c746c91c813381aebdd3a12` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/292a7c82beeef71102411cb0782c25ef60a20396b131cc375d4f7c1a8d090546`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

vjeçari shqiptar, trupi i të cilit u gjet brenda një automjeti Fiat Bravo të zhytur në lumin Tergola, në zonën e San Giorgio delle Pertiche, në Itali.

Viktima është identifikuar si **Ferdinant Hoti**, 35 vjeç, me banim në Mirano. Identifikimi është bërë nga karabinierët përmes gjurmëve të gishtërinjve.

Ekzaminimet mjeko-ligjore kanë konfirmuar se shqiptari është vrarë me armë zjarri. Sipas mjekut ligjor Rafi El Mazloum, i cili kreu autopsinë, 35-vjeçari është qëlluar nga një distancë e afërt. Në momentin e ekzekutimit, viktima i kishte duart e lidhura.

Një tjetër element i rëndësishëm është se viktima kishte ndërruar jetë para se trupi të përfundonte në ujë. Në mushkëritë e tij nuk janë gjetur shenja uji, çka tregon se ai nuk është mbytur, por është hedhur në lumë pasi kishte vdekur.

**Automjeti ishte pa targa**

Hetuesit kanë zbuluar gjithashtu të dhëna të reja për automjetin. Fiat Bravo e zezë, e gjetur pa targa në basenin e Tergolës, është identifikuar përmes numrit të shasisë.

Automjeti rezulton në pronësi të një burri që banon në provincën e Venecias, i cili nuk kishte raportuar vjedhjen e makinës. Karabinierët po e marrin në pyetje për të sqaruar nëse mund të ketë lidhje me ngjarjen.

Trupi i 35-vjeçarit u gjet në bagazhin e automjetit, i futur në një thes të zi, ndërsa mbi të ishin vendosur goma automjetesh, të përdorura si peshë për të mbajtur trupin të zhytur në ujë.

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor: Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

ta mbajtur trupin të zhytur në ujë.

Hetuesit po përpiqen të rindërtojnë lëvizjet e viktimës dhe të përcaktojnë me kë është takuar gjatë mbrëmjes së 7 shtatorit.

Mënyra se si është organizuar fshehja e trupit ka përforcuar bindjen e hetuesve se bëhet fjalë për një vrasje të planifikuar. Automjeti dyshohet se është shtyrë me dorë drejt ujit me qëllim që trupi të zhdukej në ujë.

Karabinierët po analizojnë të gjitha kamerat e sigurisë në zonë, përfshirë edhe kamerat e një mobilierie pranë vendit ku u gjet automjeti.

Makina është vënë re në orët e para të mëngjesit nga disa artizanë që po kalonin në zone.

Edhe pjesa e lumit ku u gjet automjeti po i nënshtrohet kontrolleve të imtësishme. Autoritetet kanë hapur portat për të ulur nivelin e ujit dhe për të mundësuar ekzaminimin e zonës.

Hetimet vijojnë për të përcaktuar autorët, motivin e vrasjes dhe nëse 35-vjeçari është vrarë në një vend tjetër përpara se trupi të transportohej dhe të hidhej në Tergola.

#ferdinanthoti #Itali #vrasje

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



VENDI

**Viti i ri shkollor/ Ministrja Kumbaro...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



VENDI

**Moti sot, java nis me kthjellime, çfarë...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv · Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.